



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.590/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj, kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e kandidatës për deputete nga radhët e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Rrezarta Krasniqi, dega në Vushtrri të paraqitur kundër, komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Vushtrri, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), Vushtrri për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2025, të parashtruara nga kandidatjapër deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Rrezarta Krasniqi paraqitur kundër komisionarëve në QKN, Vushtrri për shkak të parregullsive gjatë numërimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat me numër A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2021 të datës 16.02.2025, nga kandidatja për deputete nga radhët e subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Rrezarta Krasniqi.

Në ankesën, Anr.590/2025, pretendohet se komisioneri, Betim Grabanica në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në komunën e Vushtrrisë më datë 13.02.2025,14.02.2025 dhe 15.02.2025, ka qëndruar në QKN, gjatë tërë procesit të numërimit në dy ndërrimet dh a ka lëvizur në të gjitha tavolinat me të cilën dyshojnë se në Vendvotimet 2704/08 dhe 2702/5 ka pasur ndërhyrje në votat e kandidatëve të LDK-së.

Në ankesë kërkojnë që personi në fjalë të përjashtohet dhe këto dy vendvotime të rinumërohen.

Në ankesën, Anr.594/2025, pretendohet se komisionerët, Betim Grabanica, Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në komunën e Vushtrrisë më datë 13.02.2025,14.02.2025,15.02.2025 dhe 16.02.2025, kanë bërë keqpërdorime gjatë numërimit të votave, ashtu që kundërligjshëm kanë ndërhyrë në proces të

numërimin të votave, me të cilën dyshojnë që në të gjitha vendvotimet ka pasur ndërhyrje në votat e kandidatëve të subjektit politik LDK, ashtu që Betim Grabanica ka qëndruar në të dy ndërrimet, ndërsa Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli kanë qëndruar gjatë ndërrimit të natës, gjatë të cilave periudha dyshojnë se kanë ndodhur këto keqpërdorime. Mëtutjue në ankesë theksojnë se Andrit Tahiri dhe Remzi Sokolit janë familjar të njërit prej kandidatëve për deputet nga LDK-ja, ku theksohet se Andriti është djali i vëllait të kandidatit për deputet, kurse Remzi është dhëndri i këtij kandidati.

Kërkojnë nga PZAP-, të rinumërohen të gjitha VV që janë numëruar deri më tani.

Më datë 18.02.2025 kandidatja në fjalë ka dorëzuar në PZAP dëshmi shtesë lidhur me Ankesën A.nr. 594/2025 ku theksohet se në ankesë ka kërkuar që si provë të merren kamerat që janë të vendosura në QKN, Vushtrri. Mëtutjue thekson se në kohën e dorëzimit të ankesës nuk ka qenë në njohuri në lidhje me këtë provë të cilën e propozoi përmes kësaj parashtrëse. Përmes kësaj parashtrëse ka kërkuar që të dëgjohet personi-zyrtari i KQZ-së, Vushtrri, Shkëlzen Osmani i cili do të vërtetojë faktet e parashtruara në ankesë me të cilën ka shënuar edhe të dhënat kontaktuese të personit në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 17.02.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) theksohet se KQZ, pas shqyrtimit të ankesave dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë: Duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 1.38 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) - do të thotë lokacioni në secilën komunë ku numërohen fletëvotimet dhe votat e kandidateve të subjekteve politike, në mënyrë transparente në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar, si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, ndër Funkzionet e QKN është edhe numërimi i fletëvotimet dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike.

Mëtutjue njoftojnë se KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ-në e komunës së Vushtrrisë, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim:

KKZ, e komunës së Vushtrrisë, ka njoftuar KQZ-në, lidhur me ankesën kërkesën në A.nr.590 dhe 594/2025, të datës 16.02.2025, e palës ankuese për vendvotimin si në vijim:

Sa i përket ankesës së paraqitur ndaj numëruesit Betim Grabanica për datat 13 dhe 14 shkurt 2025, në punën e tij në QKN në komunën e Vushtrrisë, lidhur me vendvotimet 2726/01, 2704/08, dhe 2702/05, si KKZ nuk kemi pranuar ankesë nga bashkë numëruesit e tij në grup apo grupet tjera përreth, e as nga vëzhguesit lidhu me punën e tij.

Si provë në përgjigje është: Përgjigja e dërguar nga KKZ Vushtrri me datën 16.02.2025, lidhur me 590/2025

Ndërsa lidhur me pretendimet në ankesën A.nr.594/2025, KQZ ka theksuar se sa i përket numërimit ku kanë punuar numëruesit e cekur në ankesë, zi Betim Grabanica, Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokol në QKN në Vushtrri, janë shënime në librin e shënimeve në QKN dhe Formularët e zgjedhjeve FRS dhe FRK të krijuar si rezultat i punës së tyre në grupe gjatë ditëve të numërimit në QKN. Si KKZ nuk kanë pranuar ankesë nga bashkë numëruesit e tij në grup apo grupet tjera përreth, e as nga vëzhguesit lidhur me punën e tij.

Si provë në përgjigje është: Përgjigja e dërguar nga KKZ Vushtrri me datën 16.02.2025, lidhur me 594/2025. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se gjithashtu gjatë procesit të verifikimit të votave të subjekteve politike dhe numërimit të votave të kandidatëve të subjekteve politike të gjitha formularët e rezultateve për subjekte politike dhe kandidaten janë nënshkruar pa kurrfarë vërejtje nga ekipet e numërimit për të gjitha tavolinat e numërimit kua ata kanë numëruar.

Si provë në përgjigje: Formularët e rezultateve të subjekteve politike (FRS) dhe Formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK) ku kanë punuar ky ekip i numërimit

Mëtutje në përgjigje theksohet se KKZ, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese. Në vazhdim KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor duk përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunave përkatëse, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Kërkojnë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) që pretendimet e palës ankuese t'i hedhë si të pabazuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2025 të datës 16.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët Anr.590/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga i njëjti subjekt politik për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesat dhe përgjigjen në ankesë vlerësoi se :

-Ankesat janë të pabazuara.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidates për deputete, Rrezarta Krasniqi të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Vushtrri, nga komisionerët e lartcekur.

Pretendimet ankimore të parashtruesës së ankesave me numër A.nr 590/2025 dhe A.nr 594/2025, me të cilën thekson se në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), Vushtrri, janë bërë keqpërdorime gjatë numërimit të votave dhe kundërligjshëm kanë ndërhyrë në proces të

numërimin nga komisionerët, Betim Grabanica, Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli, Paneli i vlerësuesve se janë të pa qëndrueshëm dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesja e ankesave në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatojë se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në QKN të komunës së Vushtrrisë.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, vërehet se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë sepse nuk është pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe as Formularët e rezultateve të subjekteve politike (FRS) dhe Formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK) të ofruara në përgjigje nuk vërehet asnjë shënim apo vërejtje në Librin e Shënimeve në QKN, në Komunën e Vushtrrisë.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesat e parashtruara nga Rrezearta Krasniqi, kandidate për deputete e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë të pabazuara pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesja e ankesave i ka bashkangjitur dhe nga përgjigja e KQZ-së, nuk mund të vërtetohen shkeljet e pretenduara për të cilat referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshëm dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lartë. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 590/2025 më datën 18.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



AA.nr.50/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Muhamet Rexha anëtarë, në çështjen juridike lidhur me ankesën e kandidatës për deputete nga radhët e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) - Dega në Vushtri, Rrezarta Krasniqi, të paraqitur në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe parashtresa, kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) - Vushtri, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Vushtri, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09 Shkurt 2025, duke vendosur sipas ankesës së të njëjtës, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësra (PZAP), Anr.590/2025, të datës 18.02.2025, në seancën e mbajtur më datë 24.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga: Rrezarta Krasniqi, kandidatë për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) - Dega në Vushtri, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësra (PZAP), Anr.590/2025, të datës 18.02.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësra (PZAP), Anr.590/2025, të datës 18.02.2025, është vendosur: REFUZOHEN të pabazuara ankesat A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2025, të parashtruara nga kandidatja për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Rrezarta Krasniqi paraqitur kundër komisionarëve në QKN, Vushtri për shkak të parregullsive gjatë numërimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

Kundër këtij vendimi, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Rrezarta Krasniqi, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës që të: Apropojë ankesën e parashtruar me datë 20.02.2025, dhe të Ndryshojë vendimin Anr.590/2025, të datës 18.02.2025, ashtu që të: aprovoj si të bazuara ankesat A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2025, të



datës 16.02.2025, dhe të obligohet PZAP që ti ndërmarr të gjitha veprimet hetimore për dëgjimin e dëshmitarëve dhe për marrjen e kamerave në QKN Vushtrri, si dhe Obligohet PZAP të urdhëroj rinumërimin e të gjitha vendvotimeve në Vushtrri, në afat të menjëhershëm nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e kandidatës për deputete nga radhët e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Rrezarta Krasniqi, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.590/2025, i datës 18.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës, gjen se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 16.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat me numër A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2021, nga kandidatja për deputete nga radhët e subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Rrezarta Krasniqi.

Në ankesën, Anr.590/2025, të datës 16.02.2025, pretendohet se komisioneri, Betim Grabanica në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Komunën e Vushtrrisë, më datë 13.02.2025, 14.02.2025 dhe 15.02.2025, ka qëndruar në QKN, gjatë tërë procesit të numërimit në dy ndërrimet dhe ka lëvizur në të gjitha tavolinat me të cilën dyshojnë se në vendvotimet 2704/08 dhe 2702/5 ka pasur ndërhyrje në votat e kandidatëve të LDK-së. Andaj, kërkojnë që personi në fjalë të përjashtohet dhe këto dy vendvotime të rinumërohen.

Ndërsa në ankesën, Anr.594/2025, të datës 16.02.2025, pretendohet se komisionerët, Betim Grabanica, Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Komunën e Vushtrrisë, më datë 13.02.2025, 14.02.2025, 15.02.2025 dhe 16.02.2025, kanë bërë keqpërdorime gjatë numërimit të votave, ashtu që kundërligjshëm kanë ndërhyrë në proces të numërimit të votave, me të cilën dyshojnë që në të gjitha vendvotimet ka pasur ndërhyrje në votat e kandidatëve të subjektit politik LDK, ashtu që Betim Grabanica ka qëndruar në të dy ndërrimet, ndërsa Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli kanë qëndruar gjatë ndërrimit të natës, gjatë të cilave periudha dyshojnë se kanë ndodhur këto keqpërdorime. Më tutje në ankesë theksojnë se Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli janë familjar të njërit prej kandidatëve për deputet nga LDK-ja, ku theksohet se Andriti është djali i vëllait të kandidatit për deputet, kurse Remziu është dhëndri i këtij kandidati. Andaj, kërkojnë nga PZAP, të rinumërohen të gjitha vendvotimet që janë numëruar deri më tani.

Më datë 18.02.2025 kandidatja për deputete Rrezarta Krasniqi, ka dorëzuar në PZAP dëshmi shtesë lidhur me Ankesën A.nr.594/2025 ku theksohet se, në ankesë ka kërkuar që si provë të merren kamerat që janë të vendosura në QKN, Vushtrri. Ka shtuar se në kohën e dorëzimit të ankesës nuk ka qenë në njohuri në lidhje me këtë provë të cilën e propozoi përmes kësaj parashtrëse. Përmes kësaj parashtrëse ka kërkuar që të dëgjohet personi-zyrtari në KQZ-së,



Vushtrri, Shkëlzen Osmani i cili do të vërtetoj faktet e parashtruara në ankesë me të cilën ka shënuar edhe të dhënat kontaktuese të personit në fjalë.

Më datë 16.02.2025, PZAP-i, njoftoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ankesat e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 17.02.2025 në ora 14:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 17.02.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: Duke u bazuar në nenin 3 paragraf 1.38 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) - do të thotë lokacioni në secilën komunë ku numërohen fletëvotimet dhe votat e kandidatëve të subjekteve politike, në mënyrë transparente në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar, si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, ndër Funkcionet e QKN është edhe numërimi i fletëvotimet dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. KQZ pas pranimi të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ-në, më komunën e Vushtrrisë, nga e cila ka pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: KKZ, e komunës së Vushtrrisë, ka njoftuar KQZ-në, lidhur me ankesën kërkesën në A.nr.590/2025 dhe 594/2025, të datës 16.02.2025, e palës ankuese për vendvotimin si në vijim: Sa i përket ankesës së paraqitur ndaj numëruesit Betim Grabanica për datat 13 dhe 14 shkurt 2025, në punën e tij në QKN në komunën e Vushtrrisë, lidhur me vendvotimet 2726/01, 2704/08, dhe 2702/05, si KKZ nuk kemi pranuar ankesë nga bashkë numëruesit e tij në grup apo grupet tjera përreth, e as nga vëzhguesit lidhur me punën e tij. Ndërsa lidhur me pretendimet në ankesën A.nr.594/2025, KQZ ka theksuar se sa i përket numërimit ku kanë punuar numëruesit e cekur në ankesë, si Betim Grabanica, Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokol në QKN në Vushtrri, janë shënimet në librin e shënimeve në QKN dhe Formularët e Zgjedhjeve FRS dhe FRK të krijuar si rezultat i punës së tyre në grupe gjatë ditëve të numërimit në QKN. Si KKZ nuk kanë pranuar ankesë nga bashkë numëruesit e tij në grup apo grupet tjera përreth, e as nga vëzhguesit lidhur me punën e tij.

Në vazhdim të përgjigjes theksohet se gjithashtu gjatë procesit të verifikimit të votave të subjekteve politike dhe numërimit të votave të kandidatëve të subjekteve politike të gjitha formularët e rezultateve për subjekte politike dhe kandidaten janë nënshkruar pa kurrfarë vërejtje nga ekipet e numërimit për të gjitha tavolinat e numërimit ku ata kanë numëruar. Ka shtuar se KKZ, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese. Në vazhdim KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunave përkatëse, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë. Kërkojnë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) që pretendimet e palës ankuese t'i hedhë si të pabazuar.



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në përgjigje në ankesë në tërësi e kundërshton ankesën e paraqitur kundër vendimit A.nr.590/2025, të datës 18.02.2025, duke shtuar se mbeten në tërësi pranë vendimit të kundërshtuar, i cili është në tërësi në pajtim me Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ka shtuar se pas pranimit të ankesave me numër A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2021, të datës 16.02.2025, nga kandidatja për deputete nga radhët e subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Rrezarta Krasniqi kundër komisionarëve në QKN, Vushtri për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në vendvotime, ka shqyrtuar pretendimet ankimore lidhur me keqpërdorimet e mundshme gjatë numërimit të votave dhe ndërhyrjes së kundërligjshme në procesin e numërimit nga komisionerët, Betim Grabanica, Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli, dhe të njëjtat PZAP i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesja e ankesave në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-se, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mund të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në QKN të komunës së Vushtrrisë.

Tutje theksohet se, kjo gjendje është vërtetuar edhe nga përgjigja e KQZ-së, ku është theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë sepse nuk është pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe as Formularët e rezultateve të subjekteve politike(FRS) dhe Formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK) të ofruara në përgjigje nuk vërehet asnjë shënim apo vërejtje në Librin e Shënime në QKN, në Komunën e Vushtrrisë. Andaj, Paneli ka vlerësuar se ankesat e parashtruara nga Rrezarta Krasniqi, kandidate për deputete e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë të pabazuara pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesja e ankesave i ka bashkangjitur dhe nga përgjigja e KQZ-së, nuk mund të vërtetohen shkeljet e pretenduara për të cilat referohet pala ankuese.

Andaj PZAP, propozon që ankesën A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2021, të datës 16.02.2025, të parashtruara nga kandidatja për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Rrezarta Krasniqi, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, A.nr.590/2025 të datës 18.02.2025, të refuzohen të pabazuara ndërsa vendimi i ankimuar të vërtetohet si i bazuar.

PZAP, në vendosje si në vendimin e tij të ankimuar gjen se, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidates për deputete, Rrezarta Krasniqi të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), konstatoi se ankesa është e pabazuar.

Fillimisht, paneli thekson se në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.590/2025



dhe A.nr.594/2025 të datës 16.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr. 590/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga i njëjti subjekt politik për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP, në arsyetimin e vendimit të kontestuar ndër të tjera thekson se: Pretendimet ankimore të parashtrueses së ankesave me numër A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2025, me të cilën thekson se në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), Vushtrri, janë bërë keqpërdorime gjatë numërimit të votave dhe kundërligjshëm kanë ndërhyrë në proces të numërimit nga komisioneret, Betim Grabanica, Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesja e ankesave në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e te provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në QKN të komunës së Vushtrrisë.

Ka shtuar se: edhe nga përgjigja e KQZ-së, vërehet se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë sepse nuk është pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe as Formularët e rezultateve të subjekteve politike (FRS) dhe Formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK) të ofruara në përgjigje nuk vërehet asnjë shënim apo vërejtje në Librin e Shënime në QKN, në Komunën e Vushtrrisë.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesat e parashtruara nga Rrezearta Krasniqi, kandidate për deputete e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë të pabazuara pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesja e ankesave i ka bashkangjitur dhe nga përgjigja e KQZ-së, nuk mund të vërtetohen shkeljet e pretenduara për të cilat referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesja e ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë. Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke bazuar në nenin 117 par.3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, i pranon si të themelta dhe të bazuara konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të PZAP-it, të marrë si në vendimin e ankimuar, A.nr.590/2025, të datës 18.02.2025, andaj ankesat, A.nr.590/2025 dhe A.nr.594/2025, refuzohen si të pabazuara.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet ankimore të parashtrueses së ankesës. Pretendimet lidhur me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës, ku ndër të tjera theksohet se: vendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative nga neni 52 par.1, nën par. 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, lidhur



me nenin 48 të LPPA-së, për shkak se PZAP nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankueses, si dhe nuk ka treguar shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave dhe si rrjedhojë e të cilave ka ardhur deri tek konstatimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, kolegji i kësaj gjykate i refuzoj si të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme po ashtu pretendimet lidhur me formën dhe përmbajtjen e vendimit, në referim të nenit 48 dhe 52 të LPPA-së, janë të pabazuara për faktin se, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet në ankesë lidhur me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, ku ndër të tjera theksohet se; nga dëshmitari i propozuar SH.O, si dhe nga kamerat e vendosura në QKN, do të vërtetoheshin pretendimet e ankueses, kolegji i refuzoj si të pathemelta dhe të paqëndrueshme, ngase parashtruesja e ankesës, as pranë organit të administratës dhe as pranë kësaj gjykate, nuk ka ofruar dëshmi dhe prova të qarta dhe bindëse, për të provuar pretendimet e saj se në vendvotimet 2704/08 dhe 2702/5, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Komunën e Vushtrisë, më datë 13.02.2025, 14.02.2025 dhe 15.02.2025, ka pasur ndërhyrje në votat e kandidatëve të LDK-së, apo që komisioneret, Betim Grabanica, Enis Maxhuni, Andrit Tahiri dhe Remzi Sokoli, në qendrën e njëjtë, më datë 13.02.2025, 14.02.2025, 15.02.2025 dhe 16.02.2025, kanë bërë keqpërdorime gjatë numërimit të votave, duke ndërhyrë kundërligjshëm në proces të numërimit të votave, në favor të kandidatëve të subjektit politik LDK. Edhe sipas vlerësimit, të kolegjit të Gjykatës Supreme me pretendimet e lartcekura ankimore të ankueses nuk vihet në dyshim gjendja faktike e vërtetuar si më lartë nga PZAP si në vendimin e tij të kontestuar, andaj pretendimet e ankueses refuzohen si të pathemelta.

Gjendja faktike e përshkruar si në arsyetimin e vendimit të kontestuar është vërtetuar drejtë, duke u marrë për bazë edhe përgjigja e KQZ-së, ku është theksuar se KKZ-në, në Komunën e Vushtrisë, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatët në QKN, dhe as në Formularët e rezultateve të subjekteve politike (FRS) dhe Formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK), nuk vërehet asnjë shënim apo vërejtje në Librin e Shënimeve në QKN, në Komunën e Vushtrisë. Andaj edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, veprimet e përshkruara në ankesa dhe provat e ofruara janë të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu dëshmuar se ka pasur ndonjë ndërhyrje të paligjshme në procesin zgjedhor, që lidhen me shkeljen e rregullave përgjatë procesit të numërimit të votave.

Kjo gjendja e vërtetuar si më lartë Gjykata Supreme vlerëson se PZAP-i, me rastin e vendimmarrjes ka vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet relevante dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e LZP-së, për deri sa nga parashtruesja e ankesës nuk është provuar me prova të argumentuara se vërtetë ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në QNR-Vushtri, nga ana e disa komisionerëve të cilët i cek. Me pretendimet në ankesë nuk vëhet në dyshim gjendja faktike e vërtetuar si më lartë si në vendimin e kontestuar, të PZAP, andaj kjo gjykatë i vlerëson të pathemelta pretendimet në ankesë, përkitazi me shkeljet e dispozitave të procedurës dhe vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.



Gjykata Supreme po ashtu vlerëson se vendimi i kontestuar i PZAP-së, nuk është i përfshirë as me shkelje të drejtës materiale, nga neni 117 par.3 dhe 4, si dhe neni 15 par.1 dhe 3, nënpar.3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.7, 3.9 të Rregullores nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, siç pretendon ankuesja në ankesë. Vendimi i PZAP-së është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Sipas neni 117 paragraf 3 dhe 4 [Procedurat e PZAP-së] të Ligjit Nr.08/I-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: *“3. Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse. 4. PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar”.*

Ndërsa, sipas neni 118 [Vendimet], të këtij ligji përcaktohet se: *“1. PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”.*

Sipas neni 13 par.2 [Vendimarrja e PZAP-it], të Rregullores nr.01/2025, të Panelit Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtrësia (PZAP), përcaktohet se: *“PZAP-i aprovon ankesat e bazuar në fakte dhe refuzon ankesat në mungesë të provave”.*

Kolegji i kësaj gjykate, duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP, dhe dispozitave të lartcekura, vlerëson se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, nga rezultoni se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe me Rregulloren nr.01/2025, të Panelit Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtrësia (PZAP), andaj në mungesë të provave të qëndrueshme nuk mund të urdhërohet rinumërimin e fletëvotimeve.

Nga theksimet si më lartë dhe në pajtim me neni 118 paragraf 1, të Ligjit Nr.08/I-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
AA.nr.50/2025, me 24 Shkurt 2025

Kryetar i kolegjit,
Ragip Namani

Republika e Kosovës  Republika Kosovo



SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE


Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUBSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA-50/2025
Oznaka spisa:

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lënies së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqjuit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijema _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

(Të panevojshmeve bjeri vize - nepotrebne prectati)

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT 67 UKIM

24.02.2025

Numri i shtojcave: 2

broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma (i slovima)

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je pismeno primilo u zameni)

AA-50/24.02.2025

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

onu 16:20

Në rast se marrësi është analbet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesit, duke shënuar shkaku në marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ajo je primilac neptsmen ili nije u stanju da se potpis, potpisuje ga dostavljaoc, napomenom zastio primilac nije stavio svoj potpis.